FETARIZMI DHE LIDHJA E TIJ ME BEGATITË E ZOTIT NË GJITHËSI

ROLI I XHAMISË NË EDUKIMIN E SHOQËRISË

XHAMIA E PARRUCËS, SIMBOL ISLAM I SHKODRËS

Viti XV - Nr. 3 (169), Mars, 2017

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme Informative - Fetare Kulturore - Edukative

"BOTA SOT KA NEVOJË PËR NJË ISLAM TË QARTË E TË SHËNDOSHË QË SHIHET ME SY!"

Pse e admiroj Muhammedin? Përgjigje islamofobëve!

Një nga arsyet pse e admiroj Muhammedin është se ai ishte predikues dhe mbrojtës i barazisë. Në predikimin e fundit që mbajti në Malin e Arafatit ai tha: "Arabi nuk ka epërsi ndaj jo-arabit, as jo-arabi nuk ka epërsi ndaj arabit...i bardhi nuk ka epërsi ndaj të ziut dhe as i ziu nuk ka epërsi ndaj të bardhit, përveçse në devotshmëri dhe në punë të mira." Predikimi i Profetit garantoi liri për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë. Mesazhi i tij demokratik mund të konsiderohet si pararendës i kushtetutës amerikane, që mbron të njëjtat vlera të barazisë, dhe të botëvështrimit plularist të etërve themelues, të tillë si Xhorxh Uashingtoni dhe Benxhamin Frenklin.

“BOTA SOT KA NEVOJË PËR NJË ISLAM TË QARTË E TË SHËNDOSHË QË SHIHET ME SY!”

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Tema e konferencës së sivjetshme vjetore, që është caktuar nga komisioni organizativ, ka në thelb të saj rininë dhe edukimin fetar.

Në fakt, është një temë e qëlluar, duke marrë parasysh realitetet e përditshme të shoqërisë sonë shqiptare, ku rinia e këtij vendi, jeton në një atmosferë të mbushur me pasiguri, mungesë ekuilibrash intelektualë e moralë, tendenca të frikshme korruptive, thuajse në çdo aspekt të jetës, afetarizëm ekstrem, tendenca përherë në rritje drejt zhveshjes nga tabani i të parëve besimtarë e qytetarë të disiplinuar, mungesë mundësishë për të bërë përpara etj.

Këtyre realiteteve, i shtohet edhe fatkeqësia e madhe e abuzimit global me imazhin real të Islamit, si fe hyjnore, ndihmuar edhe nga keqleximet e fesë, interpretimet e ngurta dhe të ngushta, mungesa e urtësisë në komunikimin masiv, ndryshimi i dy anëve të peshores së përparësive në trajtimin e çështjeve fetare, mungesa e dialogut, fanatizmi grupor me tendencë të fshehtë sektare, mungesa e largpamësisë në trajtimin e fenomeneve aktuale në peshoren e fesë islame; Kur’anit, Synetit dhe Historisë shekullore etj.

Në këto kontekste, detyra dhe roli i prijësve fetarë, imamëve, teologëve, thirrësve islamë, vaizëve, hatibëve, përkthyesve e të angazhuarve në këtë rrugëtim shekullor në shërbim të Thirrjes Islame, bëhet përherë e më i rëndësishëm, shumë serioz dhe jetik për të mirën e shoqërisë.

Në këto 27 vite të ripërtëritjes islame në vendin tonë, bashkësia e jonë fetare ka kaluar dallgë të forta, tronditje, lëkundje, goditje e humbje ekuilibri për shkaqe e rrethana, që nuk janë objekt i këtij mesazhi dhe kësaj konference.

Asnjëherë nuk duhet ta lëmë pas dore leximin me vëmendje të detajeve që lidhen me misionin tonë fisnik dhe shërbimet që kemi për detyrë t’ia ofrojmë individit, shoqërisë, kombit, ymmetit tonë!

Po të shihni me vëmendje, nga viti në vit, tendencat për ta heshtur a dobësuar zërin e arsyes së komunitetit më të madh fetar në vend, kanë ardhur duke u shtuar. Politika, media dhe mungesa e thirrësve islamë cilësorë, kanë një rol esencial në këtë drejtim.

Nga viti në vit, muslimanët etiketohen me lloj-lloj shpifjesh dhe denigrimesh, ndaj të cilave shumë pak është reaguar si duhet, kur duhet dhe në formën e duhur!

Ditëve të fundit dëgjuam edhe një krahasim të frikshëm, (që assesi nuk duhet ta pranojmë dhe ta kthejmë mbrapsht), ku u vendos në diskutim besueshmëria e krerëve fetarë të vendit!

Jo se prijësit fetarë nuk gabojnë, gabojnë edhe ata, se janë njerëz! Madje, gabimet e tyre peshojnë më rëndë sesa ata të atyre që u është tharë uji i fytyrës dhe nëpërkëmbin ditë pas dite të drejtat e njerëzve dhe hakun e pasurive, që Zoti i ka falur tokës, pa iu dridhur qerpiku!?

Nga ana tjetër, le ta pyesë veten secili prej nesh, sesa i besueshëm jam në misionin tim? Sa i aftë jam? Sa punoj dhe angazhohem për këtë mision të shenjtë? Sa e justifikoj me punën dhe sakrificën time, të jem Myfti, imam, vaiz, hatib, thirrës islam?

Nëse krerët dhe prijësit fetarë, që përçojnë ditë pas dite Fjalën e Hakut dhe mesazhet e harmonisë dhe bashkëjetesës në shërbim të interesit të madh të paqes sociale dhe harmonisë kombëtare nuk janë të besueshëm, ose më pak të besueshëm se kushdo tjetër, do të thotë se dikush po gënjen veten, Zotin, të tjerët, Zot na ruaj!

TË NDERUAR,

Tema të tilla, si: “terrorizmi islam”, (Realisht, mendoj se duhet falënderuar publikisht ndërhyrja elitare e presidentit turk, Rexheb Taip Erdogan në konferencën e tij me kancelaren gjermane në këtë drejtim, reagim që u reflektua në mënyrë të qytetëruar nga zonja Merkel.), “radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm islam”, “organizatat terroriste” me matricë islame etj., po bëhen përherë e më të pranishme, si një përpjekje e bezdisshme për të frikësuar njerëzinë, sidomos shoqëritë e painformuara e të paditura ndaj të vërtetave islame, për t’u distancuar prej tij dhe për ta konsideruar si një armik të përbetuar të njerëzimit!

Pikërisht në këtë moment, shërbimet tona, të imamëve dhe predikuesve në veçanti, marrin një dimension shumëfish më të madh në raport me përgjegjësinë e fjalës, sjelljes, shembullit personal, komunikimit, hapjes dhe dialogut, durimit dhe sakrificës, mostundimit dhe përpjekjes së pandërprerë për realizimin e madh të vërtetësisë shekullore në fjalët e Resulull-llahut (a.s): “Do të mbërrijë kjo fe, ku ka mbërritur nata dhe dita!”

Të gjithë ju e dini fare mirë se e vërteta qëndron krejt ndryshe nga ofendimet, shpifjet dhe propaganda islamofobike, që ka përfshirë botën, përfshi vendin tonë të vogël. Ju e dini dhe e përhapni me shumë dinjitet, ditë pas dite, faktin se Islami dhe terrorizmi janë dy gjëra të ndryshme, që nuk lidhen as përkojnë në asnjë detaj me njëri-tjetrin. Për pasojë, muslimani nuk mund të jetë terrorist, nuk mund të jetë vrastar, kriminel, i droguar, imoral, i shthurrur dhe injorant!

Këto mesazhe, ju ia përcillni ditë pas dite dhe mesazh pas mesazhi, xhematit tuaj, shoqërisë, rinisë në mënyrë specifike!

TË DASHUR TË PRANISHËM,

Në shtator të vitit 2001, pata zhvilluar një intervistë të gjatë me të nderuarin, Dr. Alauddin Hamvi, thirrës islam i afirmuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në shumë vende të Europës dhe në Siri, ku jeton dhe punon akoma edhe sot. (Personalisht dhe disa të nderuar në këtë sallë, e kemi pasur fatin e mirë ta kemi pedagog të lëndës së Akides, ditëve të studimeve në Siri).

Intervistën e tij me titull: “Argëtimi i rinisë”, e pata përfshirë në librin tim me titull: “Opinione bashkëkohore islame”, Shkodër, 2002.

Dua t’i rikthehem sërish mesazheve të asaj interviste, që e gjej me vlerë dhe me dobi për thelbin e kësaj konference.

“Islami është fe e jetës, e gjallërisë, e aktivitetit dhe medoemos që argëtimi në jetën e muslimanit zë një vend të qartë. Mirëpo argëtimi në Islam është i drejtuar, dmth, se muslimani nuk argëtohet për të humbur kohën, por edhe argëtimin e vendos në një vend të duhur, duke e ruajtur kohën e tij, duke u mbrojtur nga harami, duke respektuar të drejtat e tjerëve e duke mos u sjellur atyre ndonjë të keqe.

Argëtimin e shohim në shumë forma që në kohën e Pejgamberit (a.s), që i mësonte sahabët të argëtoheshin, duke u marrë me aktivitete të ndryshme sportive, si: gara kalorësie, me not, me marrje në shenjë etj.

Ndërkohë, problemet morale nuk kanë kartë identiteti, pra nuk mund të themi problemet morale perëndimore apo lindore, poashtu edhe argëtimin s’mund ta quajmë lindor apo perëndimor.

Le t’i vështrojmë gjërat sipas qëllimeve të tyre, sipas vlerave, prandaj çdo çështje varet nga rezultati i saj. Nëse rezultati i saj është i mirë, Islami e përqafon atë dhe nuk ka asnjë problem në këtë pikë.

Islami nuk është kundër asnjë grupi apo populli, por të thotë: Ti kush je dhe çfarë bën dhe, punët tuaja a kanë vlerë apo jo? E nëse e gjen të mirën edhe tek një mexhusi (adhurues i zjarrit) e merr këtë të mirë, pasi Pejgamberi (a.s) thotë: “Urtësia është plaçkë e humbur besimtarit, ku ta gjejë atë e merr”, pa shikuar se të kush është kjo urtësi. ... Por cilat janë alternativat e këtyre veprimeve nga aspekti islam? Argëtimi islam, pikë së pari, është ngritur mbi rregullin që do thotë se personaliteti yt është i barazpeshuar, pa lëkundje. Ti s’je një kundërveprim, por ti je veprim!

Kundërveprimet, zakonisht janë negative e të pavlera. Psh, kur njeriu e vendos dorën e tij në një send të nxehtë, çfarë vepron? E tërheq dorën e tij me të shpejtë. Kjo shpejtësi mund të godasë dikë dhe mund të shkaktojë ndonjë dëm.

Islami nuk është kundërveprim, ai është veprim! Përherë mendon, kërkon!

Islami nuk i ndalon gjërat që mund të përdoren për të mirë apo për të keqe, por e ndihmon myslimanin për t’i përdoruar mirë këto gjëra.

Do t’ju jap një shembull të thjeshtë: Me këtë lapsë që kam në dorë, njeriu mund të shkruajë fjalë të pista e të ndaluara, por mund të shkruajë me të edhe fjalë të vlefshme... Islami thotë: Ne nuk e ndalojmë përdorimin e lapsës, por të mësojmë ta përdorësh për shkrime të bukura e me vlerë!

Me një gotë njeriu mund të pijë një pije dehëse, por mund të pijë me të edhe ujë Zemzemi... Atëherë ne nuk e ndalojmë përdorimin e gotës, por themi: Përdore si duhet këtë gotë!

Po ashtu edhe televizioni, internet etj., të gjitha këto mund të përdoren për të prishur moralin e sjelljen, ndërsa Islami të thotë: Mos i ndalo, por përdori si duhet!

> **Asnjëherë nuk duhet ta lëmë pas dore leximin me vëmendje të detajeve që lidhen me misionin tonë fisnik dhe shërbimet që kemi për detyrë t’ia ofrojmë individit, shoqërisë, kombit, ymmetit tonë!**

Mendo për të krijuar faqe islame në internet, mendo të realizosh filma, drama, emisione e reklama islame në televizion, mendo të krijosh kanale televizive islame!

Këto fjalë Islami ia thotë atyre që duan të arrijnë në gradët e larta të civilizimit njerëzor, pasi është shumë e thjeshtë të ulesh në shtëpinë tënde e të thuash: Kjo është haram, kjo e ndaluar, kjo ashtu e kjo kështu!

Do mbesësh në vendin tënd e bota do të ecë përpara. Bota ecën duke mos shikuar prapa!

Feja është vërtetësi dhe realitet, që s’lidhet me kohë! Psh. dalja e diellit... Dilte në kohën e Ademit, Muhammedit, në kohën tonë e deri në ditën e kiametit... Dielli është vërtetësi që nuk ndryshon.

Të ushqyerit me gojë është vërtetësi... Ademi ka ngrënë me anën e gojës edhe ne ushqehemi me anën e gojës... vërtetësi! Islami është vërtetësi, që do thotë se nuk ka lidhje me ndonjë kohë të caktuar, prandaj duhet ta zbatojmë sa të mundemi.

Pra, në lidhje me alternativat islame, themi se Zoti (xh.sh) përpara se t’i ndalonte gjërat, nuk ndaloi domosdoshmëritë e jetës sonë. Ndaloi pijet dehëse, por na lejoi të pijmë pije freskuese joalkoolike. Ndaloi adulterinë, por na lejoi martesën.

Pra, nuk ndaloi asgjë të domosdoshme, nuk ndaloi asgjë pa i gjetur një alternativë tjetër të vlefshme!

Njerëzit sot në kohën e materializmit, për fat të keq jetojnë një jetë materialiste që e bën individin të mos mendojë vetëm se në ushqimin, pijen, martesën, gjumin dhe që e ndalon të mendojë për këtë zemër që është baza.

Prandaj Pejgamberi (a.s) na tërheq vëmendjet tona për t’i drejtuar te kjo zemër, që të argëtohet herë pas here, për të arritur në një barazpeshë.

Për fat të keq njeriu e ka keqkuptuar lirinë që i ka dhënë Zoti, prandaj e shohim shpeshherë duke vepruar djathtas e majtas me ekstremitet, duke e bërë jetën e tij të zbrazët nga argëtimi dhe pushimi, nga adhurimi dhe përshpirtja.

Mirëpo kush e shpërdoron atë natyrë që ka vendosur Zoti për jetën e njeriut, do të pendohet pas njëfarë kohe!

Muslimani është ai që përherë i barazpeshon punët e tij, sepse moral i muslimanit është barazpeshimi i punëve, edhe pse është një gjë e vështirë, por jo e paarritshme.

Të mendojmë së bashku se si të thërrasim të tjerët në Islam nëpërmjet radios, televizionit, internetit apo kanaleve të ndryshme!

Duhet të punojmë seriozisht për të zgjedhur “sofrat” më të mira për paraqitjen e këtij Islami të pastër. Psh. radioja është “sofër”, televizioni është “sofër”, interneti poashtu... Pra, le të zgjedhim për veten tonë më të mirën dhe le t’i mbushim këto “sofra” me atë çka vlen, që do i shërbejë krejt shoqërisë.

Bota sot ka nevojë për një Islam të qartë e të shëndoshë që shihet me sy... Njerëzit nuk duan ligjërata! Ata duan të shijojnë, duan vërtetësi, duan punë!

Pejgamberi (a.s) nuk ka urdhëruar që të mbyllemi nëpër xhamia apo vende të tjera, por na ka kështilluar që të shpërndahemi ndër njerëz e t’u paraqesim atyre vlerën e Islamit me veprat tona, që ata ta shikojnë me sytë e tyre mrekullinë e tij!”

Në përfundim të këtij mesazhi,

Lutem me zemër që All-llahu i Madhëruar të na dhurojë mbarësi dhe sukses në shërbimet tona ndaj kësaj Thirrjeje të begatë Islame, si dhe ta udhëzojë rininë tonë drejt Islamit dhe mesazheve të tij të mbushura me jetë, optimizëm, dije e urtësi, harmoni dhe vlera, që e ndërtojnë jetën mbi tokë dhe e bëjnë njeriun të jetojë me dinjitet, si krijesa më e përzgjedhur e Zotit!

All-llahu ju dashtë e ju dhashtë mbarësi!

Shkodër, më 25 shkurt 2017

(Nga mesazhi i mbajtur në konferencën e 6-të vjetore të imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës, me temë: “Rinia dhe edukimi fetar”)

FETARIZMI DHE LIDHJA E TIJ ME BEGATITË E ZOTIT NË GJITHËSI

"Ai është, i Cili ju krijoi juve prej balte pastaj caktoi exhelin (afatin) dhe exheli (afati) i caktuar ndodhet tek Ai"

Shejkh Muhamed El-Gazali

Ka diçka, e cila ka lidhje me mesazhin e fesë, në mesin e të gjallëve. Me të vërtetë unë urrej fetarizmin e distancuar nga bukuria e gjithësisë dhe madhështia e saj, fetarizmin shterp, që nuk kupton sekretet e gjithësisë dhe nënshtrimin e saj në dobi të interesave njerëzore.

Për disa çaste, kur po lexoja Kur'an, më mbërthyen ndjenjat se, Zoti xh.sh. dëshiron të kthejmë vështrimin nga krijimi i Tij, në njerëzit dhe horizontet. Kërkon të nxisë ndjenjat tona në atë që ekziston në gjithësi prej saktësisë, përpikërisë, bukurisë dhe fuqisë. Kërkon nga njerëzit të vështrojnë argumentet e madhështisë së Tij në këtë gjithësi, e cila dëshmon, ditën dhe natën, për Zotin që është Rregullatori i saj.

A mos ndoshta Zoti betohet në elementet e gjithësisë kotë së koti? Shikoni tek kjo panoramë!

"Betohem në dritën e kuqe (muzgun) e perëndimit. Në natën dhe çka mban ajo. Në hënën kur merr formën e saj të plotë..." - (El-Inshikak: 16-18)

Patjetër është një pamje origjinale e horizontit të kuqërremtë, të cilin e pason perëndimi i diellit dhe dalja e hënës. Pastaj një panoramë tjetër e asaj, që e ndjek pas këtë moment kohe:

"Pasha natën që vjen me errësirë dhe mëngjesin kur agon". - (El-Lejs: 1-2)

Bota po lëviz dhe dridhet me fllade zgjonjëze të hershme!

Ai që krijoi qiejt e tokën dhe vendosi dritën e errësirat, kërkon nga ne të zbulojmë cilësitë e Tija, anekënd mbretërisë së Tij. Që të shikojmë tek bota se, ajo është vendi i shpalosjes së emrave të Tij të bukur, ku më pas të ndërtojmë cilësitë tona me besim të fortë dhe bindje të plotë, të udhëzohemi me dritën e Tij. Ne punojmë në tokë si për t'u përgatitur për udhëtimin e kthimit, udhëtim që patjetër do të vijë.

"Ai është, i Cili ju krijoi juve prej balte pastaj caktoi exhelin (afatin) dhe exheli (afati) i caktuar ndodhet tek Ai". - (El-En'am: 2)

Vërtet është për t'u habitur; të jetojnë myslimanët prej disa shekujsh dhe nuk dinë asgjë nga ajo që thuhet për gjithësinë! Të jenë shkencat e saja dytësore në kulturën e tyre, si tek intelektualët ashtu edhe tek njerëzit e thjeshtë. Të jetë dituria për sekretet dhe energjitë e saja prej gjërave luksoze pa rëndësi të madhe tek disa dhe, si diçka qesharake e kotë te disa të tjerë!

Çfarë e ka mbërthyer interesimin e tyre mbi artet e dijes? Në kohën kur myslimanët u larguan nga studimet e gjithësisë, të tjerët u thelluan në atë rrugë, korrën suksese të habitshme, pastaj i vunë në shërbim të besimeve të tyre dhe filozofive të pavlera! Pa dyshim këtë ndarje mizore mes fesë nga njëra anë dhe, jetës e gjithësisë nga ana tjetër, Islami e refuzon me plot gojë dhe kërkon nga robërit e mirë të Zotit një rrugë tjetër, e cila me forcë e kundërshton këtë ndarje.

Ndoshta mund të thuash: "Ne e dimë këtë gjë dhe s'po na flet diçka të re...!"

Përgjigjem: "Nuk pushojnë së renduri të rinjtë, të cilët dëshirojnë kthimin e të punojnë për Islamin, t'i kthejnë shpinën botës dhe shkencave të saja, t'i zbrazin çantat e tyre nga kërkimet hulumtuese të energjive të ndryshme jetësore dhe, mendojnë se dhikri, përmendja e Allahut, e falënderimi në adhurim janë rilindje"!

Mora pjesë në një seminar për çështjet të thirrjes, i cili u mbajt në Nouakçot, kryeqyteti i Mauritanisë. Në atë vend, pashë një grup prej komunistëve kinez, të cilët nuk punonin për qiellin, por për tokën. Kishin arritur të zbulonin burime të pastra uji dhe kishin shtrirë tubat e ujitjes nëpër tokat e zhuritura, që kishin nevojë për ujë!

Gjithashtu kam parë disa prej komunistëve kinez në Jemenin lindor, duke çarë zemrën e Saharasë me rrugë të asfaltuara në mes të vargut të maleve! Thashë me vete: Nga fundi i lindjes, prej larg e më larg, kanë ardhur që të ndërtojnë në vendet tona! Po çfarë punojmë ne?

Ai që krijoi qiejt e tokën dhe vendosi dritën e errësirat, kërkon nga ne të zbulojmë cilësitë e Tij, anekënd mbretërisë së Tij.

Ndjeva zemërim të madh kur mora vesh se Katari mysliman eksportonte grurë, ditëve kur ishte i kolonizuar, ndërsa kur fitoi pavarësinë dhe, qeverisja ra në duart e banorëve të saj, toka u tha dhe filloi importimi i grurit nga jashtë!

Më erdhi turp, kur po numëroja shtetet e industrializuara dhe nuk gjeta mes 10 të parave, as 10 të dytave e, as të paktën një shtet islam të vetëm!!

Dihet që Japonia filloi mëkëmbjen e saj, afërsisht përpara një shekulli dhe, po në të njëjtën kohë filluan edhe disa shtete islamike. Ndërsa Japonia arriti deri në maja të zhvillimit, ne mbetëm të varfër. Cili është shkaku? Ndoshta rol të madh mund të ketë prishja politike, por prishja kulturore, për mendimin tim, ka një rol kryesor.

Çfarë mund të thuash për djelmosha, të cilët duan të ndezin beteja për disa çështje fare të vogla në veshje dhe të tjera, kur këto janë më afër synetit të traditës, se sa synetit të adhurimit dhe, ndoshta gjërave parësore i vjen fundi.

Fenë e Allahut, nuk kanë fuqi ta mbajnë dhe as ta ruajnë dështuesit në fushat e civilizimit njerëzor, llafazanët e botës së fshehtë, gajbit, memecët e botës së dukshme.

Ndjej se detyra e myslimanëve për t'u thelluar shkencërisht në shërbim të fesë dhe të dynjasë së tyre, ka nevojë për një shpjegim të madh, sepse kënaqësia e injorantëve me atë që kanë prej njohurive të rreme, është neglizhencë e çështjes që nuk përballohet dhe, në rast se nuk ua bëjmë të qartë të gjithë realitetin, të vërtetën, ymetit tonë, atëherë ai dhe ne së bashku jemi të destinuar të shkatërrohemi.

(Nga libri: "Probleme në rrugën e jetës islame", përktheu nga arabishtja: Lavdrim Hamja)

SIKUR TË DUKESHIN QËLLIMET, NUK DO TË DUKESHIN VEPRAT

"O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim siç bën ai që e jep pasurinë e vet sa për sy e faqe të njerëzve, e nuk e beson All-llahun dhe as botën tjetër." (El-Bekare: 264)

Hfz. Mehas Alia
Imam, "El-Hidaje", St.Gallen - Zvicër

Falënderimi i takon Zotit të botëve, salavatet dhe selamet i takojnë të Dërguarit të Tij, familjes, shokëve dhe gjithë atyre që e pasojnë për të mirë deri në ditën e gjykimit.

"O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim siç bën ai që e jep pasurinë e vet sa për sy e faqe të njerëzve, e nuk e beson All-llahun dhe as botën tjetër. Shembulli i tij është si një gur i madh e i lëmuar që mbi të ka pak dhe, e kur e godet atë një shi i madh e lë të zhveshur (lakuriq). Ata (formalistët) nuk arrijnë asgjë nga ajo që punuan. All-llahu nuk e udhëzon popullin jobesimtar." (El-Bekare: 264)

"Veprat çmohen sipas qëllimit dhe se çdokujt i takon ajo që e ka për qëllim." (Buhariu dhe Muslimi)

Po ashtu, në një hadith tjetër, i dërguari i Allahut, Muhammedi (a.s) ka thënë: "Allahu nuk shikon format e trupit dhe pasuritë e juaja, por shikon zemrat dhe veprat tuaja." (Muslimi)

Për t'i pasur veprat e pranuara te Zoti, duhet nijetin ta kemi të pastër dhe të drejtë. Allahu nuk e pranon një vepër, sado e madhe të jetë, nëse ajo nuk e ka një qëllim të mirë dhe vetëm për Zot.

Nga ana tjetër, ne si njerëz, nuk mund t'i vlerësojmë qëllimet (nijetet) e të tjerëve, pasi nuk mund t'i dimë. Ne vetëm mund t'i vlerësojmë veprat dhe në bazë të tyre japim vlerësimin. Vetëm Allahu (xh.sh) i di qëllimet.

Një problem tjetër që na del përpara në këtë temë, është se ne, shumë shpesh, në vend se të merremi me veprat dhe rezultatet e tyre, merremi me qëllimet. Nuk themi se sa e madhe është vepra, por themi se ajo vepër është bërë për këtë qëllim apo për atë qëllim.

Me këtë rast, njeriu duhet të ketë kujdes të madh që ta përputh nijetin me veprën, fjalët me punët, si dhe rezultatin e angazhimit me qëllimin. Shumë shpesh mund të shohim vepra të mëdha të njerëzve, por pasi nuk ua shohim qëllimet, i vlerësojmë ato lartë. Por, sikur t'i shikonim qëllimet, veprat nuk do të dukeshin aspak.

Njeriu, vazhdimisht, duhet t'i shqyrtojë qëllimet dhe duhet të jep mund që t'i ruaje ato, sepse nijetet mund të prishen edhe më vonë. Mundet që nijeti që nga starti të jetë i gabuar dhe i prishur, por ka mundësi që të prishet edhe më vonë.

XHEMAT I SHTRENJTË

E marrim si shembull një njeri që ndihmon xhematin apo ndonjë projekt në xhami. Në fillim e bënë atë vetëm për Allahun (xh.sh) dhe nuk kërkon asnjë falënderim dhe mirënjohje për punën dhe angazhimin. Shejtani nuk ka mundur assesi, direkt, me ia prish nijetin. Çfarë mund të ndodhe këtu? Tash mund të vijë në lojë një tjetër, i cili punon shumë, por që qëllimin nuk e ka për Allah. Ka ndonjë qëllim tjetër; dëshiron ta lavdërojnë, t'i japin mirënjohje, t'i thonë se sa shumë punon, apo mund të ketë ndonjë qëllim tjetër, siç është shpërblimi, pozita dhe fama.

Në momentin që ai i pari e sheh këtë të dytin, fillon të mendoje se, vallë, unë përse punova? Pse ky të shpërblehet, e unë jo?! Pse atij t'i përmendet emri, e mua jo? E kështu me radhë, shejtani vazhdon përmes tjetrit me ia prish qëllimin të parit, të cilit, fillimisht, nuk pati mundësi t'i bëj dëm për t'ia humbur qëllimin e pastër që kishte për Allahun (xh.sh).

Shembulli i dytë: Një njeri është duke agjëruar agjërim nafile (vullnetar). Gjatë ditës del në xhami apo shkon diku mysafir dhe me qëllim e sjell muhabetin te agjërimi, për të treguar se është agjërueshëm. Ky person, kështu, e ka prish nijetin, dhe si rrjedhojë i ka humbur edhe vepra, pra ka mbetur pa shpërblim. Një vepër që në Ahiret mund të tërheq shpërblime kapitale, prishet me ta përmendur dhe me t'u lavdëruar me të.

Shembulli i tretë: Njeriu bën vepra të mira, hajrate. Për të tilla vepra nuk janë paraparë dhurata, shpërblime, mirënjohje, medalje, etj. Nuk e pengojnë njerëzit që janë më të dobët dhe punojnë më pak se ai. Por, kur takohet me ata që janë më të mirë, punojnë dhe japin më shumë, fillon e xhelozon, fillon dhe urren, dhe kështu ndërton qëndrim negativ ndaj tyre. Në vend se t'i lutet Allahut (xh.sh) që t'i shpërblejë ata që angazhohen dhe ta forcojë këtë në rrugën e mirësisë, fillon t'i urrejë ata që angazhohen dhe sakrifikojnë. Kështu, shejtani, edhe këtij ia prish nijetin dhe ia humb veprat.

TË NDERUAR VËLLEZËR DHE MOTRA

Ta ruash nijetin dhe sinqeritetin në vepra, është gjë e rëndë dhe e vështirë. Këtë më së miri e ka përshkruar Er-Rraziu: "Gjëja më e vështirë në botë është sinqeriteti. Ah, sa përpiqem që nga zemra ta hedhë këtë hipokrizi, por sikur gjithnjë nga zemra më mbinë në ndonjë formë tjetër!" (Ibn Rexhep El-Hambeli).

Allahu të na ruaje inshallah nga kurthet e shejtanit dhe të na i ruaje nijetet e mira!

(Hytbeja e xhumasë, 24.03.2017, xhamia "El-Hidaje", St. Gallen - Zvicër)

"Veprat çmohen sipas qëllimit dhe se çdokujt i takon ajo që e ka për qëllim."
(Buhariu dhe Muslimi)

XHAMIA E PARRUCËS, SIMBOL ISLAM I SHKODRËS

"Ezani i sabahut të ditës së xhuma, më 23 mars 2007, sinjalizoi fillimin e emocioneve të mëdha të një dite, që do të mbahet mend gjatë në kujtesën e besimtarëve muslimanë dhe qytetarëve shkodranë... Emocionet e kësaj dite janë të lidhura me historinë, me të shkuarën, me të tashmen, me të ardhmen e këtyre besimtarëve, me Shkodrën dhe me brezat, që pasojnë njëri-tjetrin..."

Të dashur e të nderuar vëllezër besimtarë,

"Ezani i sabahut të ditës së xhuma, më 23 mars 2007, sinjalizoi fillimin e emocioneve të mëdha të një dite, që do të mbahet mend gjatë në kujtesën e besimtarëve muslimanë dhe qytetarëve shkodranë... Emocionet e kësaj dite janë të lidhura me historinë, me të shkuarën, me të tashmen, me të ardhmen e këtyre besimtarëve, me Shkodrën dhe me brezat, që pasojnë njëri-tjetrin. Emocionet e kësaj dite janë të lidhura me gëzimin e madh të përurimit të xhamisë së re të Parrucës, në qendër të qytetit të Shkodrës."[1]

Pa asnjë dyshim, përurimi i xhamisë së Parrucës, (xhamia e dytë më e madhe në Shkodër, pas asaj të Fushë Çelës), 10 vite më parë, do të shënonte një ngjarje me shumë rëndësi për historinë e Shkodrës dhe lidhjes së saj me shpirtin e Thirrjes Islame dhe trashëgiminë e shekujve, që Shkodrës i dhanë ngjyresën e kulturës dhe etiketës identitare, që e ka shoqëruar përherë dhe vazhdon.

Në kujtesën qytetare të Shkodrës, është memorizuar, se: "Nga objektet kryesore të lagjes Parrucë ka qenë xhamia e saj... Nga fundi i vitit 1967 u rrenue në kuadrin e lëvizjës antifetare, (lëvizje histerike e një zullumi të pashembullt shtetëror, për të cilën asnjë qeveri e këtyre 27 viteve të fundit, nuk ka kërkuar falje publike përpara muslimanëve të mbarë Shqipërisë, përë këtë dhe krejt krimet e komunizmit në dëm të Islamit dhe muslimanëve shqiptarë!) – (shënim imi, M.S.)...

Para se të ndërtohej xhamia e re, ishte e vjetra, ma e vogël, me një minaret guri të pamjeshtri... Ajo ndërtesë e vjetër nuk dihet se kur ishte e ndërtueme, mbasi nuk kishte asnjë datë ase mbishkrim. Nga të dhanat popullore kuptohet se ishte e ndërtueme në shekullin 18 me fondete familjes Jukej...

Turqit kanë pasë shfaqë dëshirën për ta zmadhue në model të xhamive të përmenduna të Stambollit. Mjerisht

Xhamia e Parrucës, 1938

të parët e shtëpisë së Jukejve e kundërshtuen, sepse në atë rast do të prisheshin disa oborre. Qeveria turke, tue mos dashtë të qesë trazime e të prishë qetësinë, hoqi dorë nga kjo nismë.

Për pozicionin që kishte, në zemër të qytetit, çdo ceremony fetare, sikurse të kënduemit e Mevludit, të puthunit të Qymes së Pejgamberit etj, celebrohej në këtë xhami, shpesh herë edhe në prani të valiut dhe të autoriteteve të tjera civile e ushtarake."[2]

Sipas të dhënave historike, nga viti 1936 nisin përpjekjet e Myftinisë Shkodër për ndërtimin e një xhamie të re. "Titullari i Kryemyftinisë, Salih efendija, i mbështetun në atë fond (600 napolona ar)mori inisiativën të ndërtonte një xhami të re. Kjo xhami u pat ndërtue në bazë të planit të inxhinierit Sadi Pashallarit. Ka qenë një ndër xhamitë më të bukura të Shqipnisë, e pajisun me dy minaret të holla e të nalta afro 40 metra... Ishte llogaritë që kjo xhami të përfshinte ma tepër së dy mijë veta...

Xhamia ka qenë themelue me 16 maj 1937 me një dua të zavendës/kryemyftisë Hafiz Halil Puka dhe me një bisedë të H. Esat Myftisë... Xhamia ka qenë përfundue ën vitin 1943-44... Pjesë artistike të mihrabit dhe të kubeve e pat marrë mbi vete, vullnetarisht, i mirënjohuni mësuesi veteran Shefqet Kraja, i cili punoi tre muaj me radhë..."[3]

Ndërkohë, përurimi i xhamisë së re të Parrucës, 40 vite pas shkatërrimit të saj nga shteti shqiptar, në vitin e errët 1967, sinjalizoi nisjen e një ere të re për muslimanëte Shkodrës, përtë cilën të gjithë jemi përgjegjës dhe duhet ta ruajmë si sytë e ballit, duke mos lejuar për asnjë arsye përsëritjen e historiusë, edhe pse, herë pas here, bijtë në pushtet të atyre që e shkatërruan, përpiqen të nxjerrin kokën e së keqes që s'u zhgulet dot nga shpirtri katran, akoma sot!

Nga 23 mars i vitit 2010 e deri sot, kanë kaluar plot dhjetë vite, në të cilat xhamia e Parrucës, është dëshmuar si një qendër e mirëfilltë e aktiviteteve të larmishme të Myftinisë Shkodër dhe si një simbol islam i patjetërsueshëm i muslimanëve të Shkodrës dhe përtej saj.

Vit pas viti, xhamia e Parrucës është kthyer në një kible të natyrshme, sidomos për rininë muslimane shkodrane, që viti pas viti ka dëshmuar një rritje të mrekullueshme në frekuentimin e riteve fetare, ndjekjen e hytbeve të xhumasë, frekuentimin e aktiviteteve të larmishme, tribunave fetare, kurseve të ndryshme, takimeve sporadike plot dobi me imamët e nderuar të saj, sikurse është dëshmuar si një qendër bamirësie, saherë që Myftinia Shkodër ka drejtuar thirrjet e saj për besimtarët, sipas situatave dhe nevojave të kohës.

S'ka dyshim se, (ashtu si e ka shkruar në përshtypjet e tij edhe prefekti i Shkodrës, në kohën e përurimit, z. Maxhid Cungu): "Rikthimi i kësaj xhamie pas 40 vitesh, është një nga ngjarjet më të rëndësishme në qytetin dhe qarkun tonë..."[4]

Ndërkohë, nuk duhet të harrojmë asnjëherë, faktin se: "Një simbol i muslimanizmit i vjen përsëri qytetit tonë pas 40 vjetësh, xhamia e Parrucës e dashtun për të gjithë ne. I shtohet edhe

1. Muhamed Sytari, suplement me rastin e përurimit të xhamisë së Parrucës, gazeta "Udha Islame", nr. 54, mars 2007, f. 1.

2. Hamdi Bushati, "Shkodra dhe motet", botimi i dytë, Shkodër, 2005, vëll. 1, f. 85.

3. Po aty, f. 86.

4. Maxhid Cungu, suplement me rastin e përurimit të xhamisë së Parrucës, gazeta "Udha Islame", nr. 54, mars 2007, f. 3.

Xhamia e Parrucës, 27 mars 2007

"Sot, në këtë ditë të bukur, në këtë orë të lutjesnga ky vend që rrezaton besim e shpresë, kujtojmë me respekt e nderim, dijetarët tanë të shkuar, hoxhallarët, myftilerët,vaizët e imamët e nderuar që i dhanë famën e merituar xhamisë së Parrucës."

një institucion më shumë i rëndësishëm edukues me moralin islam, veçanërisht rinisë tonë..."[5], sikurse shkruan edhe rektori i Universitetit të Shkodrës, asokohe, prof. dr. Mahir Hoti.

E përfundoj me një pjesë nga hytbeja e mbajtur të xhumanë e parë të përurimit të kësaj xhamie të shtrenjtë për ne, nga Imam Ndriçim Sulejmani, asokohe Myfti i Zonës Shkodër, kur thotë: "Sot, në këtë ditë të bukur, në këtë orë të lutjesnga ky vend që rrezaton besim e shpresë, kujtojmë me respekt e nderim, dijetarët tanë të shkuar, hoxhallarët, myftilerët, vaizët e imamët e nderuar që i dhanë famën e merituar xhamisë së Parrucës.

Kujtojmë sot dhe lutemi për shpirtrat e myftilerëve të nderuar: Jusuf ef. Tabaku, Adem ef. Vehbiu, Hafiz Tahir Myftia, Xhemal Naipi, Molla Fasli Zylja, Salih ef. Myftia, Hafiz Sabri Bushati, Hafiz Abdullah Neziri, Hafiz Halil Tophana dhe Hafiz Xhemal Çanga.

Sikurse kujtojmë dhe nderojmë imamët, vaizët dhe shërbestarët e shumtë të xhamisë së Parrucës, ku përmendim: Hafiz Sheuqet Boriçin, Haxhi Muhamed Bekteshin, Sheh Qazim Hoxhën, Hafiz Esat Myftinë etj, gjurmët e të cilëve mbetën të gdhendura në zemrat e besimtarëve dhe kujtesën historike të këtij qyteti besimtar."[6]

TË NDERUAR IMAMË, TË DASHUR TË PRANISHËM,

Përfitoj nga rasti të rishfaq mirënjohjen e Myftinisë Shkodër për donatorin kryesor të kësaj xhamie, z. Said Fishta, për imamët e nderuar Alban Kali, Naim Drijaj dhe Durim Kasemi, për muezinët e palodhur H. Daut Shabaj dhe H. Besnik Saraçi, për të kudogjendurin në shërbim të kësaj xhamie dhe kontributeve të vazhdueshme në dobi të saj, H. Besnik Elbasani. Sikurse falënderoj nga zemra të gjithë imamët e nderuar të Shkodrës, që në momente të caktuara dhe sipas programeve të larmishme të organizuar nga institucioni i Myftinisë, dhanë kontributin e tyre të çmuar, duke rrezatuar dije dhe kulturë besimi nga minberi dhe kursija e kësaj xhamie. Njëkohësisht falënderoj të gjithë myftilerët e qyteteve të tjera, si dhe personalitetet e shquara të Thirrjes Islame në rang kombëtar, rajonal dhe botëror, që ligjëruan nga kjo xhami me ftesën tonë. All-llahu i shpërbleftë!

Mbarësi dhe suksese të vazhdueshme aktivitetit plot përgjegjësi të krejt të ngarkuarve me besim për të shërbyer në këtë xhami historike. All-llahu iu bëftë ndihmë dhe i qoftë Mbrojtës dhe Udhëzues në rrugëtimet e gjata të saj! Amin!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 23 mars 2017

5. Prof. Dr. Mahir Hoti, suplement me rastin e përurimit të xhamisë së Parrucës, gazeta "Udha Islame", nr. 54, mars 2007, f. 3.

6. Imam Ndriçim Sulejmani, suplement me rastin e përurimit të xhamisë së Parrucës, gazeta "Udha Islame", nr. 54, mars 2007, f. 4.

Sabri ef. Bajgora
(Kryeimam i BIK)

Për Ty o Allah

Në thellësitë e pafundme
të oqeanit shpirtëror
I shkrirë në ekstazën
e ëmbëlsisë hyjnore
Ndjej lehtë një dridhje
tek më përshkon në kraharor
Allah! O Zot i kësaj
ekzistence madhështore

Vetëm Ty të takon përjetësia,
Vetëm për Ty është adhurimi
Vetëm Ty të takon pafundësia,
Vetëm për Ty është madhërimi

O Zot i vetëm i kësaj gjithësie
Që shpirtrat tanë në Dorë i ke
Na fal neve këtë ndjenjë mirësie
Mos na le të vuajmë,
në humbje mos na le.

Zemra ime vetëm Ty të kërkon
Këtë shpirt timin
mos e le në errësirë
Emri Yt
tërë qenien ma drithëron
Na dhuro o Zot,
rahmet e mëshirë

PSE E ADMIROJ MUHAMMEDIN? PËRGJIGJE ISLAMOFOBËVE

Unë e shikoj Muhammedin shumë ndryshe nga këta fanatikë. Ky shkrim i shkurtër evidenton karakterin e tij shembullor dhe i sfidon islamofobët të mendojnë ndryshe për Profetin.

Dr. Craig Considine
Rice University, Houston - USA

Islamofobët më kanë sulmuar sepse kam shkruar pozitivisht për Muhammedin, Profetin e Islamit. Duke qenë se jam katolik, më konsiderojnë si heretik dhe aktivitetet e mia ndërfetare i konsiderojnë si sakrilegj. Për këta kritikë, Islami është djallëzor dhe Muhammedi nuk është tjetër përveçse një terrorist. Unë e shikoj Muhammedin shumë ndryshe nga këta fanatikë. Ky shkrim i shkurtër evidenton karakterin e tij shembullor dhe i sfidon islamofobët të mendojnë ndryshe për Profetin.

Një nga arsyet pse e admiroj Muhammedin është se ai ishte predikues dhe mbrojtës i barazisë. Në predikimin e fundit që mbajti në Malin e Arafatit ai tha: "Arabi nuk ka epërsi ndaj jo-arabit, as jo-arabi nuk ka epërsi ndaj arabit...i bardhi nuk ka epërsi ndaj të ziut dhe as i ziu nuk ka epërsi ndaj të bardhit, përveçse në devotshmëri dhe në punë të mira." Predikimi i Profetit garantoi liri për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë. Mesazhi i tij demokratik mund të konsiderohet si pararendës i kushtetutës amerikane, që mbron të njëjtat vlera të barazisë, dhe të botëvështrimit plularist të etërve themelues, të tillë si Xhorxh Uashingtoni dhe Benxhamin Frenklin.

Gjithashtu e admiroj Profetin Muhammed sepse ai predikoi tolerancën fetare, veçanërisht në raport me të krishterët dhe hebrejtë. Në traktatin e Medines, Profeti u tha ndjekësve të judaizmit se "ju do të jetoni në paqe... ju do të jeni të sigurt nën sundimin tim... Ndaj jush s'do të ketë armiqësi dhe nuk do t'ju bëhet keq." Njësoj si në marrëdhënien e tij me hebrenjtë, Muhammedi donte të mbronte të krishterët, që nga muslimanët konsideroheshin gjithashtu si njerëz me një status të veçantë. Në një marrëveshje që bëri me murgjërit e krishterë të Malit të Sinait, Muhammedi i garantoi ata se gjykatësit e krishterë do të mbroheshin dhe kishat do të ruheshin. Teksti i marrëveshjes thotë se muslimanët duhet t'i konsiderojnë të krishterët dhe hebrenjtë si motrat dhe vëllezërit e tyre që janë robër të të Gjithëfuqishmit.

Në dritën e këtyre traktateve dhe marrëveshjeve, sulmet e fundit nga ISIS ndaj minoriteteve fetare në Siri dhe Irak janë tejet tronditëse, pasi vijnë në kundërshtim të hapur me predikimin e Profetit për tolerancë mes pasuesve të traditës abrahamike.

Duke shtrirë tolerancën fetare tek jo-muslimanët, Muhammedi luftoi për të drejtat e njeriut. Profeti donte që gratë të ishin të lira në mënyrë që të jetonin sipas zgjedhjes së tyre. Dy nga bashkëshortet e tij më të afërta e vërtetojnë këtë. Bashkëshortja e tij e parë, Hatixhja, ishte një tregtare e suksesshme që drejtonte një karvan të madh tregtar. Bashkëshortja tjetër e tij, Aishja, u bë një nga dijetaret dhe juristet kryesore muslimane, për më tepër ajo është dijetarja e parë femër në Islam. Bazuar në marrëdhënien që kishte me bashkëshortet e tij, mund të themi se Profeti besonte se gratë duhet të mbanin pozicione drejtuese në shoqëri, duke u përfshirë në çështje të rëndësishme që i përkasin ligjit dhe politikës. Integrimi i këtyre grave në shoqërinë arabe dëshmon se Muhammedi nuk dëshironte që gratë të jetonin të izoluara, përkundrazi, ai synonte që ato të bëheshin pjesëtare aktive të shoqërisë.

Edhe disa detaje të tjera, më të vogla se barazia, toleranca fetare dhe të drejtat e njeriut më bëjnë ta vlerësoj Profetin Muhammed. Kur'ani, siç i është zbritur Muhammedit, u kërkon muslimanëve të mos i fyejnë dhe të mos përqeshin njerëzit. Profeti besonte se përdorimi i nofkave të pakëndshme ishte diçka e keqe dhe u kërkonte pasuesve të tij të tregoheshin civilë në ndërveprimin me njëri-tjetrin. Ai gjithashtu na mësoi rëndësinë e thjeshtësisë, dhe i nxiti muslimanët, por edhe jomuslimanët, që të ishin modestë dhe të kërkonin falje për gabimet e tyre.

Islamofobët që nuk shikojnë vlera në cilësitë e Muhammedit, thjesht po tregohen mendjengushtë. Nëse Profeti do të ishte gjallë, ai do të tregohej i mëshirshëm dhe i dhembshur me ta, pavarësisht sjelljes së tyre. Ai gjithashtu do t'u kërkonte ta njihnin më mirë.

(www.profetimuhamed.info nga huffintonpost.com)



ROLI I XHAMISË NË EDUKIMIN E SHOQËRISË

Idmir Plaku
imam, xhamia "Ebu Bekër"

Falënderimi ndaj Allahut është mirënjohje që i përgjigjet së mirës, e cila gjithmonë zbret në këto vende e tubime të tilla dhe mirësisë e cila gjithmonë është e dhuruar.

Të flasësh për rolin e xhamisë në edukimin e shoqërisë në ditët e sotme është domosdoshmëri. Kjo për faktin se fryma e besimit në Një Zot dhe e vlerave morale që ajo i përçon shoqërisë, sa kalon pragun e derës së saj, përballet me një realitet tërësisht tjetër.

Që në ditët e para të Islamit roli i xhamisë në edukimin e shoqërisë mbetet i pazëvendësueshëm. Këtë e faktoi vetë Pejgamberi (a.s) sapo arriti në Medine, sepse hapi i parë që ndërmori ishte ndërtimi i xhamisë. Me të drejtë mund të lind pyetja: Përse hapi i parë ishte ndërtimi i xhamisë? Kjo nuk ishte rastësi, por një projekt largpamës për shoqërinë e shtetin që do formonte.

Nëse në ditët e sotme xhamia kuptohet nga shume njerëz si vend adhurimi, në kuptimin më të thjeshtë të fjalës ndërkohë që xhamia ka qenë dhe mbetet një burim shpirtëror i pashtershëm për besimtarët që kërkojnë përsosmërinë e shpirtit dhe vlerave morale të tyre.

Roli i xhamisë në shoqëri është në përpjesëtim të drejtë dhe në shërbim të qëllimit parësor të krijimit të njeriut: adhurimit të Allahut. Allahu (xh. sh) thotë: "Xhamitë janë veçantë për ta adhuruar Allahun, prandaj mos ju lutni askujt tjetër në to, krahas Allahut". – (El-Xhin: 18) Vlen të theksohet se koncepti i adhurimit në Islam nuk është vetëm kryerja e disa veprimeve gjatë namazit. Adhurimi sipas kuptimit islam përfshin të gjitha aspektet e jetës dhe fushat e saj.

Ndërtimi i xhamisë nga Pejgamberi (a.s) në Medinë tregoi se roli kryesor i saj është përkujtimi i Allahut, ruajtja, forcimi dhe përhapja e besimit nëpërmjet adhurimit. Pa ndërtimin e xhamisë do të ishte e vështirë bërja e vëllazërimit të besimtarëve, një nga themelet bazë të formimit të shoqërisë islame. Ndërtimi i xhamisë u bë djepi i parë i arsimit dhe kulturës islame.

Përgjatë historisë, xhamitë nuk kanë shërbyer vetëm si vend adhurimi, por edhe si qendra shkencore dhe kulturore. Xhamia duke gëzuar një status dhe vlerësim të tillë në shoqëri, ajo ka qenë dhe mbetet pjesë e pandashme e progresit të saj. Në brendësinë e saj u formuan personalitete e udhëheqës me famë botërore si Ebu Bekri, Umeri, Alia (r.anhum) e shumë të tjerë, apo dijetarë të asaj kohe, madje jehona e veprave të tyre vjen edhe në ditët e sotme. Mjafton të sjellim në kujtesën tonë dijetarë të njohur që u arsimuan nën kupolën e xhamisë , si Ibën Ruzhdi, Ibën Sina,(Avicena), Ibën Haldunin (sociologu i parë në histori) etj. Të gjithë këta dijetarë u arsimuan në ato shkolla e Universitete të ngritura pranë xhamive.

Duke lexuar gjurmët e qytetërimit islam vërejmë se xhamia ka qenë dhe mbetet një gur themeli i formimit të shoqërisë, mbrojtëse e denjë e identitetit dhe kulturës së këtij qytetërimi përgjatë gjithë historisë. Në këtë kontekst vlen të theksohet se gjatë zhvillimit të qytetërimit islam, çdoherë e në çdo vend xhamitë janë ngritur në zemrën e vendbanimeve, siç bëri edhe Pejgamberi (a.s), kur ndërtoi xhaminë në Medinën e ndritur. Kjo sepse xhamia ka të bëjë edhe me anën sociale të shoqërisë. Ajo ka qenë dhe mbetet një burim i përhershëm motivimi i bamirësisë, solidaritetit dhe mbështetje e njerëzve në nevojë.

Në xhami, si në asnjë vend tjetër, besimtarët e ndjejnë mëshirën e Allahut në afrimitetin mes tyre, në të qënurit të barabartë e të përulur para Allahut. Pa dyshim se roli edukues i xhamisë në shoqëri ka qenë e mbetet esencial. Jo pa qëllim Allahu (xh.sh) e ka vlerësuar si më mizorin njeriun që shkatërron këto objekte kulti duke thënë: "E kush mundet të jetë më mizor se ai që në xhamitë e Allahut pengon të përmendet emri i Tij dhe përpiqet për shkatërrimin e tyre". – (El-Bekare: 114) Fatkeqësisht këtë frymë shkatërruese të kësaj mizorie e përjetoi për një kohë të gjatë edhe vendi ynë. Pasojat e asaj fryme mizorie shkatërruese, shoqëria jonë i ndjen ende edhe në ditët e sotme. Çdo gur i rënë nga këto ndërtesa ka qenë një goditje në shpirtin e besimit të shoqërisë dhe vlerave morale të saj.

Në ditët e sotme roli edukativ e kulturor i xhamisë në shoqëri duhet vlerësuar maksimalisht, sepse ajo është pjesë e identitetit tonë si muslimanë. Sa më shumë të lidhur pas saj, aq më të respektuar do të jemi, aq më të qartë do ta kemi pozitën tonë në shoqëri. Këto janë institucione në të cilat përkujtohet e madhërohet Allahu (xh.sh), por edhe njeriu kupton qëllimin e krijimit të tij. Andaj rolin e saj të kultivimit të besimit e vlerave morale në shoqëri nuk duhet ta zbehë, apo lënë nën hijen e programeve shthurëse e denigruese të medieve të shkruara apo vizive. Duke vlerësuar rolin e saj kemi lartësuar emrin e Allahut, kemi vlerësuar veten, familjen e shoqërinë.

Lus Allahun që të na forcojë besimin dhe xhamitë të na i bëjë të dashura për adhurimin tonë. Amin

Shkodër, më 23 mars 2017

Roli i xhamisë në edukimin e shoqërisë mbetet i pazëvendësueshëm. Këtë e faktoi vetë Pejgamberi (a.s) sapo arriti në Medine, sepse hapi i parë që ndërmori ishte ndërtimi i xhamisë.

"EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S)" - DR. MUHAMMED A. JEMANI

PARATHËNIE E PËRKTHYESIT[1]

Të shumtë janë ata që kanë shkruar për jetën e Profetit tonë (a.s), të shumta janë studimet e ndryshme për jetën e tij, të shumtë kanë qenë e do të jenë ata që do të shkruajnë për jetën e tij, simbol i lartë në besim, në adhurimin e Zotit (xh.sh), në zbatimin e fesë, në sjellje të ndritur ndaj prindërve, grave e fëmijëve, ndaj të afërmve, komshinjve, miqve dhe armiqve në kushtet e triumfit të fesë, të luftës apo në skamje, kur xhepat e shokëve e ndihmat e tyre u bënë buxheti i shtetit të drejtuar prej tij.

Të shumtë janë ata që kanë studiuar jetën e tij: si ka ngrënë, si ka pirë, si ka ndenjur, si ka fjetur, si është veshur, si ka folur e si ka vështruar folësin, si i ka pritur miqtë dhe si është pritur prej tyre, shkurt, si e ka kaluar jetën private e shoqërore në çdo aspekt të saj. Në këtë mënyrë çdo njeri mund të përfytyrojë jetën e Profetit të madh, ndonëse nuk e ka parë e nuk ka ndenjur me të.

Të shumtë janë ata që kanë përcaktuar karakterin e sjelljet e atij Zotërie të madh, të mirë e të këqij, miq e armiq, besimtarë dhe ateistë. Nuk ka njeri në botë që i është studiuar jeta me fakte dhe argumente të sakta, sa jeta e Profetit (a.s), në bazë të diturisë e shkencës, megjithëqë ishte njeri që nuk dinte të shkruante e as të lexonte. Profeti ynë ka qenë e do të jetë shembull për të gjithë njerëzit e mbarë botës, sa të vazhdojë jeta, deri në ditën e kijametit.

Të shumtë janë të huajt, që, ndonëse nuk besojnë në profetsinë e tij, kanë shkruar për jetën e tij. Mirëpo disa kanë qenë fanatikë të fesë së vet e të verbuar nga e pavërteta, kanë folur shpeshherë gjëra të marra nga trashëgimia e baballarëve të vet, ose nga propaganda fetare etj. Prandaj janë shtrembëruar faktet dhe argumentet e si rrjedhim, ne nuk pranojmë çfarë kanë thënë ata për Profetin (a.s), kur thënia e tyre nuk i mbështetet faktit, por të fshehtës dhe armiqësisë së trashëguar.

Tomas Ernoldi në librin "Heronjtë" ka shkruar shumë fjalë të mira për Profetin Muhammed (a.s).

Francezi Endrioz ka shkruar librin "Jeta e Profetit".

Gustav Loboni në librin "Përparimi arab" ka shkruar fjalë shumë të mira për Profetin (a.s) e disa të tjerë që nuk është nevoja t'i përmendim, se ata me të vërtetë, kur kanë lavdëruar Profetin (a.s), kanë lavdëruar veten e vet, mbasi atë Zotëri e ka lavdëruar vetë Zoti (xh.sh).

Kohë mbas kohe po sqarohet madhëria e Profetit (a.s), kur edhe armiku më fanatik detyrohet të gjunjëzohet para madhërisë së tij. Një ditë, në dashtë Zoti (xh.sh), do të hapin sytë, do të hapin veshët, do të përdorin mendjen e do të besojnë se me të vërtetë Muhammedi (a.s) është Profet për mbarë njerëzimin sa të jetë jeta, ai është Profeti për të cilin kanë sinjalizuar Hz.Musai e Hz.Isai (a.s).

Po shkruaj shkurtimisht këtu, sepse ne duhet ta njohim jetën e Profetit, por kursehem në fjalë, jo se tema është e vogël, por, që të mos zgjatem tepër, mbasi edhe koha nuk më pret të shkruaj një vepër të gjatë. Të tjerë të rinj, dhëntë Zoti (xh.sh), do të shkruajnë volume më të gjata për atë jetë të çmueshme, siç kanë vepruar të tjerët në gjuhën arabe e në gjuhë të tjera për atë Zotëri.

1. Ne jemi të detyruar të besojmë në Profetin (a.s), siç thotë Kur'ani Fisnik: "Besojini Allahut dhe të dërguarit të tij dhe jepni nga ajo që Ai ju bëri trashëgues në të, se ata që besuan prej jush dhanë për hir të Zotit, ata kanë shpërblim të madh.[2]"

Ne detyrohemi të njohim jetën e Profetit (a.s), të dimë mirë gjithë veprimtarinë e atij Zotërie dhe të krijojmë bindje të thella pse duhet të besojmë tek ai si Profet.

2. Ne jemi të detyruar ta duam Profetin (a.s) më fort se veten, ashtu siç ka thënë ai (a.s): "Nuk numërohet e nuk pranohet besimtar ai njeri, deri sa të mos më dojë mua më tepër se fëmijën e vet, babën e nënën e vet e të gjithë njerëzit."[3]

Prandaj ne duhet të mësojmë jetën e Profetit, të dimë gradën e profetsisë tek Zoti (xh.sh), mrekullitë që ka bërë Zoti (xh.sh) për këtë Profet, famën e madhe, gradën e lartë mbi profetët e tjerë, ashtu siç ka thënë vetë: "Unë do të jem zotëria i gjithë njerëzisë në jetën e ardhme."[4]

Nuk mund të dojë njeriu dikë, pa ditur p.sh bukurinë trupore e shpirtërore, pa ditur karakterin e tij të lartë, pa ditur të mirat që ka bërë ai. Duke njohur jetën e Profetit Muhammed (a.s) ne mësojmë mëshirën e Zotit (xh.sh), mësojmë si të jetojmë në këtë jetë në pëlqimin e Zotit (xh.sh) me kënaqësi shpirtërore, me qetësi zemre, duke dashur të tjerët, me mirësjellje, që të gëzojmë nesër parajsën e përhershme me të gjitha të mirat që na i merr mendja pranë njerëzve të mirë, si Profeti Muhammed (a.s).

3. Ne jemi të detyruar të bindemi e të zbatojmë kërkesat e Profetit (a.s), ashtu siç ka thënë Zoti (xh.sh): "Dhe bindjuni Allahut dhe të dërguarit, ashtu që të mëshiroheni."[5]

Atëherë pra duhet të dimë me fakte të pëlqyeshme e me mendje të pastër jetën e Profetit (a.s), punët, sjelljet, urdhërat, kërkesat e ndalesat e tij e t'i zbatojmë ato, siç ka thënë Profeti (a.s) Si mundemi të plotësojmë kërkesat e t'i zbatojmë ato pa studiuar mirë jetën e këtij njeriu?

4. Ne duhet të kemi një njeri si shembull, që të ecim në gjurmët e tij e të mundohemi që t'i ngjasojmë në shumë gjëra.

Njeriu i plotë, i vetëm e i aftë në çdo pikëpamje, për t'u pasuar me sy hapur e mbyllur, është vetëm Profeti Muhammed (a.s), që nuk ka bërë asnjë të keqe gjatë jetës së vet, nuk ka gënjyer, nuk ka vjedhur, nuk ka luajtur kumar, nuk ka pirë alkool, nuk ka vrarë as nuk ka dëmtuar njeri pa faj, siç deklarojnë edhe armiqtë e tij e jo veç myslimanët.

Ai që flet pa fakte e dokumente, ai që e lëshon fjalën kot, nuk mendon se pyetet për shpifjen e fjalën e rremë, ai bën e thotë çka do, por nesër përpara Zotit (xh.sh) duhet ta dijë çka pëson për fjalët që lëshon. Ai njeri ndoshta flet keq edhe kundër Zotit (xh.sh) krijues, mëshirues, bamirës, e lëshon fjalën nga goja e jo nga mendja e logjika.

Zoti (xh.sh) në Kur'an na porosit: "Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut, (kuptohet), ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke përmendur shumë shpesh Allahun."[6]

1. Nga: Vehbi S. Gavoçi - libër i dijetarit Dr. MUHAMMED A. JEMANI: "EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED", Shkodër, 1996.

2. Kur'ani, El-Hadid: 7.

3. Transmetuar nga Muslimi.

4. Transmetuar nga Tirmidhiu.

5. Kur'ani, Ali Imran: 132.

6. Kur'ani, El-Ahzab: 21.

Duke njohur jetën e Profetit (a.s), sjelljet e virtytet e larta të tij, njerëzit do ta pasojnë, do të ndjekin rrugën e tij, do ta kenë simbol e shembull të tyre.

Haxhi Vehbi S. Gavoçi

EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S)

Mësojini fëmijët tuaj se Profeti Muhammed (a.s) është esenca e Profetëve të zgjedhur, i pari dhe i fundit i Profetëve.

Mësojini fëmijët tuaj se Muhammedi (a.s), para se të zgjidhej Profet, ishte njeri i drejtë e besnik dhe mbas profetisë ka qenë mëshira e dhururar për të gjitha krijesat.

Mësojini ata se Muhammedi (a.s) ka qënë lutja e paraardhësit te tij, Hz. Ibrahimit dhe sinjalizim e përgëzim i Hz. Musasë dhe Hz. Isasë (a.s).

Mësojini ata se Profeti (a.s) ka qenë më i vlershmi i të gjithë besimtarëve, ai është profeti për të cilin Zoti (xh.sh) ka marrë besën e Profetëvë që ishin para tij, që ta besojnë e të punojnë me të, edhe nëse dërgohet gjatë jetës së tyre.

Me të vërtetë, qjo që më ka shtyrë të përmbledh këtë libër, ka qenë dëshira për t'i nxitur baballarët dhe nënat (prindërit) ta lidhin edukimin e fëmijëve myslimanë me jetën e Profetit (a.s) dhe ai (a.s) të jetë për ta shembull i përsosur dhe tregues që të ndriçojë rrugën e tyre.

Profeti Muhammed (a.s) ka qenë e do të jetë shembull i ndritur i popullit, derisa të mbarojë jeta në këtë botë. Ky është zbatim i urdhërit të Zotit, i Cili thotë: "Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut."[7]

Në zbatim të urdhërit të Profetit (a.s) "pasoni sjelljen time dhe të ylemave të ditur Ebu Bekrit, Umerit, Osmanit, Aliut; mbani e zbatoni fenë mirë e si duhet, si ai që e kap sendin me dhëmbë e nuk e lë të bjerë." Ne, baballarët, mësuesit, prijësit jemi të detyruar të edukojmë fëmijët dhe rininë me dashuri për Profetin (a.s) dhe të anëtarëve të mirë të familjes së tij, me dashurinë ndaj shokëve të Profetit të ndershëm e të sinqertë."

Mësojini ata se Muhammedi (a.s) ka qenë njeriu, të cilit iu zbrit revelata.

Mësojini fëmijët tuaj se Profeti (a.s) është shembulli më i mirë i atyre që besojnë në Zotin (xh.sh) dhe në jetën e ardhme.

Mësojini ata se Zoti (xh.sh) është betuar mbi Profetin (a.s) e jo për të dërguarit e tjerë para tij.

Mësojini fëmijët tuaj se Profeti Muhammed (a.s) është esenca e Profetëve të zgjedhur, i pari dhe i fundit i Profetëve. Mësojini fëmijët tuaj se Muhammedi (a.s), para se të zgjidhej Profet, ishte njeri i drejtë e besnik dhe mbas profetisë ka qenë mëshira e dhururar për të gjitha krijesat.

Mbillni në zemrat e fëmijëve tuaj dashurinë për Profetin (a.s) e familjen e tij të pastër e të mirë. Kujtojuni atyre herë pas here fjalën Profetike: "Ai që më do mua, ai e do Zotin (xh.sh) dhe ai që me bindet mua, i është bindur Zotit (xh.sh)"[8]

"Thoniu atyre se besimtari nuk është i saktë në besim dhe nuk shijon ëmbëlsinë e besimit, derisa të dojë Zotin (xh.sh) dhe mua më tepër se këdo tjetër."[9]

Në vijim do të flitet për jetën e Profetit (a.s), të shokëve dhe të anëtarëve të familjes që i kam shkruar si artikuj. Sot po i përmbledh në këtë libër, që të jetë një ndihmesë modeste për brezat e rinj. Ndoshta Zoti (xh.sh) iu jep atyre nxitje për të Zoti i Madh na mëson e na lartëson përmes dashurisë ndaj Profetit (a.s). Ata që e duan atë dhe hyjnë në shoqërinë e këtij Profeti të ndershëm, gëzojnë shefaatin (ndërmjetësimin) e Zotit (xh.sh).

Të pimë nga kroni i atij Zotërie, të pimë atë ujë më të ftoftë se bora, më të bardhë se qumështi, më të embël se mjalti, pas të cilit nuk na merr etja kurrë! Të pimë nga duart e tij të ndershme! O Zot i madh, na bashko me atë Zotëri në Parajsë duke qenë i kënaqur me ne!

Shumë njerëz të ditur e shohin të arsyeshme të përfitojnë nga ngjarjet historike e të lidhin me to edukimin e foshnjeve e të rinisë, nxitin interesin e tyre ndaj madhërisë islame e historisë së besimtarëve, synojnë të ngulitin në zemrat e tyre të njoma aspektet më të vlerëshme të asaj historie madhështore. Po ashtu, studimi i historisë së Profetit (a.s) dhe njohjes së pikave kulmore të jetës së tij, të sjelljes së tij si Zotëri i mbarë njerëzimit në karakter, mendje, gjykim, drejtësi etj, krijon rastin e mirë të mësojmë fëmijët e rininë, të lartësojnë virtytet e tyre duke iu paraqitur një shembull të plotë në çdo pikëpamje.

Në këto ditë jetojmë një ngjarje të shënuar historike. Kjo është ditëlindja e Profetit Muhammed (a.s), lindja e dritës islame, që e ka mëkëmbur Profeti Muhammed (a.s).

Qe, po afrohet muaji Rebiul-ev-vel, kur ajri mbushet me aromën më të dashur për zemrat tona.

Myslimanët në të gjitha anët e botës e presin këtë rast të kënaqur, të gëzuar dhe e festojnë atë ditë si është më mirë. Këndojnë në këtë ditë Kur'anin Fisnik, kallëzojnë jetën e Profetit (a.s) dhe flasin për anët më madhështore të saj, kallëzojnë për bukurinë trupore e shpirtërore me të cilat e ka pajisur Zoti (xh.sh) Profetin Muhammed (a.s).

Përmendim se si u ndriçuan qiejt e toka nga terri i idhujtarisë dhe adhurimi i idhujve.

Përmendim se si u gëzuan qiejt, toka dhe të gjitha krijesat me lindjen e tij.

Vërtetë është rast i ndritur e i përgëzueshëm të lexojmë jetën e Profetit të pastër dhe të përmendim çfarë përmbajnë mësimet e tij udhërrëfyese.

Kjo është një prej shkaqeve të mëdha që e shtyjnë rininë të dijë madhërinë e Profetit (a.s), pasurinë e jetës së tij në besim të saktë që nuk e trondit asgjë, të ndriçuar me vepra të mëdha e sakrifica të shumta. Këto i mbushin shpirtërat e tyre me dashurinë ndaj Profetit e me madhërinë e tij morale.

Kjo gjë, kujtimi e festimi i ditëlindjes nxitin fëmijët e të rinjtë ta duan fenë e Profetin (a.s), ta lartësojnë dhe të mundohen ta zbatojnë atë.

Sa mirë është të përfitojmë për çdo vit, me rastin e ditëlindjes së Profetit (a.s) të mbledhim fëmijët, vajzat e djemtë, t'u kujtojmë jetën e Profetit (a.s), t'u mësojmë sjelljet e tij shembullore dhe veprat e bukura me të cilat e ka pajisur Zoti (xh.sh)!

Sa mirë është t'u mësojmë të rinjve se si e ka fisnikëruar Zoti (xh.sh) Profetin (a.s) me veti e cilësi të larta, më të përparuara se të Profetëve të tjerë, se si sjellja e tij është në përputhje e zbatim i Kur'anit. Vetë Zoti për të ka thënë në Kur'an: "Vërtetë ti je në një shkallë të lartë të moralit!"[10]

(vijon në numrin e ardhshëm...)

7. Kur'ani, El-Ahzab: 21.

8. Transmetuar nga Muslim.

9. Transmetuar nga Muslim.

10. Kur'ani, El-Kalem: 4.

EDUKATA DHE KUJDESI NDAJ XHAMIVE

Naim Drijaj
imam, xhamia Parrucë

Pejgamberi (a.s) ka thënë "Vendet më të dashura tek Allahu janë xhamitë". Xhamitë janë vendet më të dashura tek Zoti, sepse ato janë burim drite dhe udhëzimi.

Xhamitë janë shtëpitë e Zotit në tokë. Në to është vendi, ku mësohet praktikisht vëllazëria, vendi ku aplikohet, të paktën pesë herë në ditë, barazia përpara Krijuesit tonë, vendi ku mësohet se besimtari i mirë është ai, që do për tjetrin atë që do për vete.

Për të treguar rëndësinë e xhamisë mjafton të themi se nga gjërat e para, për të cilat u interesua i Dërguari i Allahut, sapo mbërriti në Medinë,ishte ndërtimi i xhamisë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Ai që merr abdes në shtëpinë e tij siç duhet dhe shkon në xhami, është mik i Allahut".

Në Kur'anin Famëlartë Allahu (xh. sh) thotë: "Xhamitë e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë". – (Et-Teube: 18)

Othman ibn Affan (r.a) tregon, se e ka dëgjuar Profetin (a.s) duke thënë: "Kush ndërton për hir të Allahut një xhami, Allahu do t'i ndërtojë atij një të tillë në xhenet." "Kush ndërton një xhami sa një fole zogu, apo edhe më të vogël, Allahu do t'i ndërtojë atij një shtëpi në Xhenet". "Nga veprat, sevapi i të cilave nuk ndërpritet edhe pas vdekjes së njeriut është edhe ndërtimi i një xhamie". Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Shtatë kategori njerëzish do të jenë nën hijen e Arshit të Allahut, atë ditë kur nuk ka hije tjetër përveç hijes së Tij. Ndër ta është edhe personi, që zemrën e ka të lidhur me xhamitë...".

Edukatën e besimtarit në xhami mund ta ndajmë në tri pjesë:

E para: Edukata e besimtarit nga shtëpia e tij deri tek xhamia.

1. Besimtari para se të shkojë në xhami duhet të kujdesët për pastërtinë e rrobave dhe trupit. Nëse ke një rrobë të bukur e të hijshme, dije se ajo rrobë e meriton të vishet në xhami. Allahu (xh. sh) thotë: "O bijtë e Ademit! Vishuni bukur për çdo namaz". – (El-E'araf: 31) Bëj kujdes mos të të vijë erë e keqe nga goja, nga trupi apo nga rroba jote. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Nëse dikush prej jush ha hudhra ose qepë, apo i vjen erë nga trupi, është më mirë për të, që të falet në shtëpi. Mos t'i bëjë keq atyre që ka majtas e djathta dhe le ta dijë, se melekët e Zotit ndihen keq, kur dëgjojnë erëra të këqija".

2. Ecja për në xhami duhet të jetë e qetë dhe jo e nxituar. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kur të vini në namaz, ruani qetësinë; çfarë të arrini (nga namazi) faleni dhe, çfarë t'ju ikë, plotësojeni!" "Kur ta dëgjoni ikametin, ecni (hajdeni) për në namaz duke ruajtur qetësinë dhe seriozitetin, mos shpejtoni. Çfarë të mbërrini faleni dhe, çfarë t'ju ikë, plotësojeni!"

3. Hyrja në xhami. Është e pëlqyeshme që muslimani të hyjë në xhami me këmbën e djathtë duke thënë: "Bismil-lah, All-llahum-me sal-li ala Muhammed, Rab-bigfirli dhunubi, All-llahum-meftah li ebvabe rahmetike!", që do të thotë: "Me emrin e Allahut. O Allah, dërgo salavate mbi Pejgamberin! O Allah, m'i fal gjynahet e mia! O Allah, m'i hap dyert e mëshirës Tënde!"

4. Përshëndetja e xhamisë (Tehijetul-mesxhid) Është praktikë e Profetit (a.s) falja e dy rekatëve namaz nga besimtari, i cili hyn në xhami, në shenjë respekti dhe nderimi për xhaminë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Nëse hyn dikush nga ju në xhami, le t'i falë dy rekatë namaz para se të ulet." Shumica e dijetarëve të islamit thonë se këto dy rekatë janë sunnet, nuk janë të detyrueshme.

5. Besimtari duhet të ulet aty ku gjënë vend të lirë. Nëse rreshtat janë të mbushur, nuk duhet të hidhemi mbi supet e të tjerëve që kanë arritur më përpara.

E dyta: Ruajtja e qetësisë në xhami.

1. Nuk lejohet zhurma apo biseda me zë të lartë në xhami pa qenë e nevojshme, aq më tepër kur dikush është duke u falur. Në xhami, besimtari është në komunikim me Allahun, prandaj nuk lejohet shqetësimi i askujt. Omeri (r.a) dëgjoi njëherë dy burra, që po ziheshin në xhami. Pasi mbaroi namazi, nuk i pa dhe pyeti: "Ku janë ata, që po ngrinin zërin në xhami?" i thanë: "Kanë dalë". Omeri (r.a) tha: "M'i sillni këtu". Ia sollën dhe ai i pyeti: "Prej nga jeni?" Ata iu përgjigjën: "Jemi nga qyteti i Taifit". Taifi është larg Medines. Atëherë Omeri (r.a) u tha: "Betohem në Zotin, se sikur të ishit nga banorët e Medines, do t'ju jepja një mësim, që kurrë s'do ta harronit në jetën tuaj. A nuk e keni frikë Zotin, që bëni zhurmë në xhaminë e Tij, por bërtisni dhe ngrini zërin tuaj në xhami?" Kjo kritikë e Omerit ndaj këtyre dy personave nuk është e veçantë vetëm për xhaminë e Profetit, sepse zhurma ndalohet në të gjitha xhamitë.

"Xhamitë e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë". – (Et-Teube: 18)

Abdullah ibn Abasi tregon: "Ngritja e zërit me dhikër, pas përfundimit të namazit farz, është praktikuar në kohën e Profetit (a.s)."

2. T'i japim përparësi tjetrit, të mos zihemi me askënd për asgjë. Nuk lejohet shitblerja në xhami. Profeti (a.s) ka ndaluar shitblerjen në xhami dhe ka thënë: "Nëse e shikoni një person që shet apo blen në xhami, thoni atij: "Mos të dhëntë Allahu bereqet në shitblerje!"

3. Leximi i sures Kehf ditën e xhuma. Kjo sure ka 110 ajete dhe ka zbritur në Mekë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush e lexon suren El-Kehf ditën e xhuma, e mbulon drita prej këmbëve e deri në kupën qiellore, dritë që do të ndriçojë në Ditën e Gjykimit dhe i falen të gjitha gjynahet (e vogla) midis dy xhumave."

4. Shtimi i lutjeve sa më shumë në ditën e xhuma. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Me të vërtetë, në ditën e xhuma është një kohë në të cilën, nëse muslimanët e kalojnë duke iu lutur Allahut, Allahu me të vërtetë do t'u përgjigjet atyre."

5. Dërgimi i salavateve për Pejgamberin (a.s). Profeti (a.s) ka thënë: "Shtojini salavatet për mua gjatë ditës së xhuma dhe gjatë natës së xhuma. Kush dërgon për mua një salavat, Allahu i dërgon atij dhjetë salavate."

E treta: Besimtari duhet me dalë nga xhamia me edukatë dhe me qetësi po ashtu siç ka qenë edhe hyrja e tij.

1. Dalja nga xhamia. Është e pëlqyeshme që muslimani të dalë nga xhamia me këmbën e majtë duke thënë: "Bismil-lahi, All-llahum-me sal-li ala Muhammed, Rab-bigfirli dhunubi, All-llahum-me in-ni es-eluke min fadlike!" që do të thotë: "Me emrin e Allahut. O Allah, dërgo salavate mbi Pejgamberin! O Allah m'i fal gjynahet e mia! O Allah, kërkoj nga mirësitë Tuaja!"

2. Besimtari pasi të dalë nga xhamia duhet të sillet më mirë se sa është sjellë përpara se të vinte në xhami.

Xhamitë duhet të jenë të pastra dhe të mirëmbahen.

Të gjithë krenohemi se Islami është fe e pastërtisë, se Islami na mëson të jemi të pastër në trupin, veshmbathjet dhe shtëpitë tona. Dhe normalisht, ajo pastërti me të cilën na urdhëron Islami duhet të pasqyrohet edhe në xhamitë tona.

Ebu Hurejra (r.a) tregon: "Një grua zezake pastronte xhaminë. I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) nuk e pa për disa ditë. Ai pyeti për të dhe i thanë se ka ndërruar jetë. I Dërguari i Allahut tha: "Përse nuk më keni lajmëruar"? Ai shkoi tek varri i saj dhe i fali namazin e xhenazes". Aishja (r.anha) tregon: "I Dërguari i Allahut na ka urdhëruar t'i ndërtojmë xhamitë në mes të vendbanimeve, t'i pastrojmë dhe t'i parfumosim ato".

Mirëmbajtja e xhamisë nuk është obligim vetëm për një person, por të gjithë muslimanët janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastërtinë e saj. Nëse të gjithë jemi të kujdesshëm për pastërtinë e shtëpive tona, duhet patjetër që të jemi të interesuar edhe për pastërtinë e shtëpisë së Allahut, xhamisë.

Në një rast tjetër, profeti Muhamed (a.s) duke u falur me shokët e tij, i hoqi sandalet e tija dhe i vendosi në të majtë të tij. Sahabet kur e panë një vepër të tillë, i hoqën edhe ata sandalet e tyre. Pasi mbaroi namazi, Profeti i pyeti ata: "Pse i hoqët sandalet tuaja"? I thanë: Ju pamë juve t'i hiqnit dhe i hoqëm edhe ne. Profeti (a.s) tha: "Mua më lajmëroi Xhebraili se sandalet e mia ishin të papastra".

Pastaj tha: "Nëse vjen dikush në xhami, le t'i shikojë sandalet e tija, nëse janë të papastra le t'i fshijë (pastrojë) ato, pastaj le të falet me to".

Xhamia e Profetit ka qenë e shtruar me zall dhe muslimanët në atë kohë janë falur me sandale apo këpucë. Sot ne falemi me çorape, prandaj edhe ne le t'i shikojmë çorapet tona nëse janë të papastra apo jo. Çorapi i papastër e prish higjienën e xhamisë.

Shkodër, më 23 mars 2017

Ebu Hurejre r.a transmeton se i Dërguari i Allahut a.s ka thënë:

"Sa herë që njerëzit mblidhen në një shtëpi prej shtëpive të Allahut për të lexuar librin e Allahut dhe për ta mësuar atë me njëri-tjetrin, atyre u zbresin melekët, i kaplon mëshira, i rrethojnë me krahët e tyre melekët dhe Allahtu i përmend te melekët që rrinë rreth Tij".

(transmetuar nga Muslimi)

TEOLOGU KATOLIK ZVICERAN: MUHAMEDI ËSHTË UDHËZUES I VËRTETË NË RRUGËN E SHPËTIMIT

Teologu bashkëkohor zviceran Dr. Hans Küng, i cili, ndër të tjera, është i njohur për pretendimet dhe bindjet e tij se Isa a.s., (Jezusi) ishte vetëm një njeri dhe Pejgamber i zgjedhur, për Pejgamberin e fundit, Muhamedin (s.a.v.s.) thotë:

"Muhamedi është i dërguar o Zotit në kuptimin e vërtetë të fjalës. Dhe ne nuk mund të mohojë se Muhamedi është udhëzues i vërtetë në rrugën e shpëtimit."

Ajo çfarë e karakterizon jetën e Pejgamberit të Zotit, Muhamedit, është fakti se historia na ka ruajtur komplet jetën e tij, biografinë dhe të gjitha karakteristikat e tij, dhe se në jetën dhe biografinë e tij nuk ka asnjë të panjohura dhe dykuptimësi. Ky është fakt i njohur dhe i konfirmuar nga shumë historianë perëndimorë. Kështu, historiani britanik Arnold Toynbee, thotë: "Ata që duan të studiojnë biografinë e shkëlqyer të Profetit Muhamed, do të gjejnë shumë shkrime dhe dokumente që nuk mund të gjenden te asnjë profet tjetër i Zotit."

(www.ekuiliber.com)

DISA FEMRA JOMUSLIMANE NË KANADA PROVOJNË NJË DITË ME HIXHAB

Shtatëmbëdhjetë gra kanë shprehur solidarizim dhe janë munduar të kuptojnë hixhabin gjatë kampanjës "hixhab për një ditë", që u mbajte në Universitetin e Northern Britisht Columbia në Kanada.

Kjo iniciativë ka synuar të thyej ca stereotipa për femrat që veshin hixhabin dhe praktikojnë fenë Islame.

Ata kishin lënë një kuti me shami të ngjyrave të ndryshme ku çdo femër mund ta merrte një për ta provuar ndjenjën e të veshurit hixhab. Shumë femra e kanë bërë këtë për të parandaluar diskriminimin në shoqëri. Në mesin e komenteve janë edhe këto: "Është zgjedhje. Është simbol i lirisë së shprehjes" ka thënë një nga studentet.

Disa prej tyre edhe me krenari i postuan fotot e tyre me hixhab.

Organizuesit e kësaj kampanje kanë thënë: "Mënyra më e mirë për ndier dhimbjen ose gëzimin e dikujt është ecja me këpucët e tyre për një moment."

Sipas shumë kërkimeve femrat që veshin hixhab janë shumë të diskriminuara në shoqëri në forma të ndryshme si në arsim, si në punësim, po ashtu edhe shpeshherë kanë pasur edhe sulme të ndryshme.

(www.kohaislame.com)

"Nuk ka gjynah

që del mbi faljen

dhe nuk ka gabim

që del mbi mëshirën.

As fillimet

nuk tregojnë

për përfundimet

dhe as gjërat

e dukshme

nuk tregojnë për

përcaktimet (kismetet).

Dr. Mustafa Mahmud

FAMILJA MAROKENE NË MILANO QË PRITI SI MYSAFIR PAPA FRANÇESKUN

Maroco World News i ka kushtuar një reportazh të shkurtër një ngjarjeje të rrallë të ndodhur në fundjave në Milani, ku Papa Françesku u prit si mysafir në një familje muslimane marokene. Aty përshkruhet ndjesia e rrallë që përjetuan dy palët në çastet e ngrohta që kaluan me njëri-tjetrin, e ndodhur kjo në një botë gjithnjë e më të trazuar, ku feja dhe besimi po keqpërdoren për të shkaktuar ndasi e konflikte mes njerëzve e popujve....

Papët zakonisht arrijnë në Milano me pompozitet dhe ceremoni, të përcjellë gjithnjë me autokolonë. Por ja që Papa Françeskut, i pëlqen t'i bëjë gjërat pak ndryshe, duke u shmangur nga qendra e vëmendjes dhe duke zgjedhur një rrugë më pak të pritshme, modeste e të thjeshtë, në pikëtakimet me njerëzit

Dhe, kur Mihoual Abdel Karim ka emigruar nga Maroku në Milano me familjen e tij, ai nuk e ka parashikuar se një ditë do të mirëpresë si mysafir në shtëpi pikërisht të parin e botës katolike, vetë Papën. Kjo ndodhi të shtunën në mëngjes, ku ai hapi derëb shtëpisë pas së cilës ndodhej Papa Françesku, kreun e Vatikanit, duke i uruar atij mirëseardhjen.

I ftuar në familjen e Karim, Françesku la një përshtypje të pashlyeshme në familjen që e priti atë. Karim punon në një kompani farmaceutike dhe jeton në apartament modest, por kjo nuk e pengoi që të jetë mikpritës me gruan e tij dhe tre fëmijët, kundrejt një figure botërore.

I pyetur për përvojën e papritur, Karim tha: "Ishte shumë emocionale. Ishte si të kesh një mik në shtëpi".

Ndërkohë, gruaja e Karim, si zonjë e shtëpisë u angazhua për t'i shërbyer ngrohtësisht mysafirët të veçantë, duke ofruar ëmbëlsira, arra, hurma dhe qumësht.

Milano mund të jetë kryeqyteti botëror i modës dhe ajo sigurisht është shtëpia e pamjeve turistike të paharrueshme si shtëpia e operas "La Scala". Për familjen Karim, megjithatë, ajo është thjesht një shtëpi dhe një vend ku gjithçka është e mundur ... ndoshta edhe një vizitë nga miku i tyre i ri, Papa.

(www.radiojehona.al)

SHEJHU'L - EZ'HERI QË E FLISTE RRJEDHSHËM GJUHËN SHQIPE

A do ta kishit besuar po t'ju thuhej se një nga dijetarët më të shquar të fillimit të shekullit 19-të në Egjipt, madje një Shejhu'l - Ez'her, Imam i madh i Ez'herit (posti më i lartë fetar në Egjipt) e fliste rrjedhshëm gjuhën shqipe?!

As unë s'do ta kisha besuar deri dje, kur lexova pjesë nga biografia e Shejh Hasan El-Attar që në vitin 1830 u zgjodh Shejhu i 16-të i Ez'herit, dhe që sipas studiuesit Muhammed Kamil El-Fekkij kishte udhëtuar nëpër shumë vilajete të Perandorisë Osmane me ç'rast kishte mësuar gjuhë të huaja, ndër to shqipen, turqishten e frëngjishten.

- Ensar Sinani -

Burimi: Muhammed Kamil El-Fekkij; El-Ez'her ve etheruhu fin - nahdatil-edebijetil - hadithe; fq. 161 - 187; vellimi III; botim i Akademise se Shkencave Islame ne Kajro - 1986

CNN: SHPIKJET MYSLIMANE QË I DHANË FORMË BOTËS MODERNE

Mendoni për origjinën e atij elementi kryesor të jetës moderne, siç është një filxhan kafeje, dhe mendja shkon menjëherë tek Italia. Por në fakt, është Jemeni, vendi ku fara e kudogjendur e ka origjinën e saj të vërtetë. Së bashku me universitetin e parë, dhe madje edhe furçën e dhëmbëve, janë vetëm disa ndër shpikjet e habitshme myslimanë që kanë formuar botën ku jetojmë sot.

Nga Olivia Sterns

Origjina e këtyre ideve dhe objekteve themelore, është baza e çdo gjëje: nga biçikleta e deri te shkallët muzikore. Këto janë thelbi i "1001 shpikjeve," një libër që përkujton historinë e "harruar" të 1.000 vjetëve të trashëgimisë myslimane.

"Ka një vrimë në njohuritë tona, ne kërcejmë si bretkosa nga Rilindja tek ndaj grekët e lashtë", thotë për CNN, Profesor Salim al-Hassani, kryetar i Fondacionit për Shkencë, Teknologji dhe Civilizim dhe redaktor i librit në fjalë.

"1001 Shpikjet" është tani i ekspozuar në Muzeun e Shkencës në Londër. Hassani shpreson se ekspozita do të nxjerrë në pah kontributin e kulturave jo-perëndimore, si ajo e Perandorisë Myslimane që administronte dikur Spanjën dhe Portugalinë, Italinë e Jugut dhe ishte e shtrirë në shumë pjesë të Kinës, e deri në qytetërimin e ditëve tona.

Në këtë rast, Hassani spjegon 10 shpikjet më të jashtëzakonshme të botës myslimane:

KIRURGJIA

Rreth vitit 1000, mjeku i njohur El Zahrawi botoi një enciklopedi me 1.500 faqe të ilustruar të kirurgjisë, e cila është përdorur në Evropë si një referencë mjekësore për 500 vitet e ardhshme. Ndër shpikjet e tij të shumta, Zahrawi zbuloi dhe përdorimin e zorrëve të shpërbërshme të maces për të qepur plagët. Përpara kësaj bëhej një operacion i dytë për të hequr penjët.

Ai gjithashtu thuhet se ka kryer operacionin e parë cezarian dhe krijoi pincetat operatore.

KAFEJA

Tashmë pija perëndimore për gjithë ditën, ajo u prodhua në Jemen për herë të parë, rreth shekullit të 9-të.

Në ditët e tij të hershme, kafeja ndihmoi Sufitë të qëndrojnë pa gjumë netëve vonë gjatë përkushtimit. Më vonë ajo u soll në Kajro nga një grup studentësh, por lëvizja e kafesë kaploi shpejt gjithë Perandorinë.

Deri në shekullin e 13-të ajo ka arritur në Turqi, por në Europë nuk erdhi më herët se në shekullin e 16-të ku u soll nga një tregtar prej Venediku.

MAKINA FLUTURUESE

"Abbas ibn Firnas ishte personi i parë i cili bëri një përpjekje të vërtetë për të ndërtuar një makinë fluturuese, thekson Hassani. Në shekullin e 9-ë, ai projektoi një aparat me krahë, të ngjashëm me puplat e një zogu.

Në gjyqin e tij më të famshëm pranë Kordovës në Spanjë, Firnas fluturoi lart për disa çaste, para se të bjerë në tokë ku theu pjesërisht shpinën. Planet e tij padyshim kanë qenë një frymëzim për artistin famshëm italian dhe shpikësin Leonardo da Vinçi, 100 vjet më vonë, shton Hassani.

UNIVERSITETI

Në vitin 859 një princeshë e re me emrin Fatima al-Firhi themeloi të parën Diplomë Universitare që u dha në Fez-Marok. Motra e saj, Miriam mdërtoi një xhami të bukur dhe ngjitur me të u ndërtua kompleksi Qarawiyyin al, Xhamia dhe Universiteti. Këto janë ende në funksion sot pas 1.200 vjetësh. Hassani thotë se shpreson se përkujtimi i veprës së motrave al-Firhi do të frymëzojë gratë e reja myslimane në mbarë botën sot.

ALGJEBRA

Algjebër Fjala vjen nga titulli i famshëm i traktatit të një matematikani persian që jetoi në shekullin e 9-të: "Kitab el-Xhabr Wa l-Mugabala" e cila përkthehet përafërsisht si "Libri i arsyetimit dhe i hesapeve".

E ndërtuar mbi rrënjët e sistemeve greke dhe hindu, rendi i ri algjebrik ishte një sistem unifikues për numrat racionalë, numrat irracionalë dhe madhësitë gjeometrike. i njëjti matematikan, Al-Khwarizmi, ishte gjithashtu i pari që futi konceptin e ngritjes së një numri në fuqi.

OPTIKA

"Shumë nga përparimet më të rëndësishme në studimin e optikës vijnë nga bota myslimane", vijon rrëfimin e tij profesor Hassani. Rreth vitit 1000, Ibn el-Haitham ka vërtetuar se njerëzit shohin objektet nga drita e reflektuar jashtë tyre, e cila hyn në sy, duke hedhur kështu poshtë teoritë e Euklidit dhe Ptolemeut që thonin se drita emetohet nga vetë syri. Ky fizikan i madh mysliman gjithashtu zbuloi fenomenin e dhomës së errët, e cila shpjegon se si syri sheh imazhe vertikale për shkak të lidhjes midis nervit të shikimit dhe trurit.

MUZIKA

Siç shpjegon Hassani, muzikantët myslimanë kanë pasur një ndikim të thellë në Evropë, që datojnë nga epoka e Karlit të Madh, i cili synonte për të konkurruar me muzikën e Bagdadit dhe Cordobas. Në mesin e shumë instrumenteve që mbërritën në Evropë përmes Lindjes së Mesme: janë harpa dhe Rahab, një paraardhës i violinës. Shkalla moderne muzikore janë nxjerrë si derivat i alfabetit arab.

FURÇA E DHËMBËVE

Sipas Hassanit, Profeti Muhamed popullarizoi përdorimin në masë të furçës së parë të dhëmbëve, rreth vitit 600. Duke përdorur një degëz nga pema Meswak, Ai pastronte dhëmbët dhe freskonte frymën. Substanca të ngjashme me Meswak janë përdorur në furçat e dhëmbëve moderne.

MANIVELI

Shumë nga bazat e automatikë moderne janë vënë për herë të parë në përdorim në botën myslimane, duke përfshirë sistemin revolucionar bjellë-manivelë. Nga konvertimi i lëvizjes rrotulluese në lëvizje lineare, shumë objekte të rënda lëvizeshin lehtësisht. Kjo teknologji, zbuluar nga Al-Jazari në shekullin e 12, shpërtheu në të gjithë globin, duke çuar në prodhimin e çdo gjëje: nga biçikleta tek motori me djegie të brendshme.

SPITALET

"Spitalet siç i njohim sot, me reparte dhe katedrat universitare, vijnë nga shekulli 9-të në Egjipt", shpjegon Hassani. E para qendër e tillë mjekësore ishte Spitali Ahmed Ibn Tulun, i themeluar në vitin 872 në Kajro.

Spital Tulun ka ofruar kujdes shëndetësor pa pagesë për të gjithë ata që kishin nevojë, një politikë të bazuar në traditën myslimane të kujdesjes për të gjithë ata që janë të sëmurë. Nga Kajro, spitale të tilla u përhapën në mbarë botën myslimane.

(www.tesheshi.com)

U ZHVILLUA KONFERENCA E 6-TË VJETORE E IMAMËVE TË SHKODRËS

Paraditën e së shtunës, më 25 shkurt 2017, Myftinia Shkodër organizoi konferencën e 6-të vjetore të imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës.

I pranishëm në këtë konferencë ishte edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Skënder Bruçaj, i cili dha mesazhet e tij drejtuar pjesëmarrësve në konferencë.

Kryetari i KMSh-së theksoi se detyra e imamëve dhe prijësve fetarë sot, në këto kohë të vështira plot sfida, bëhet përherë e më i rëndësishëm në drejtim të edukimit të rinisë me vlerat e besimit.

Një mesazh për imamët dhe eshe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili vlerësoi pozitat e imamëve dhe prijësve fetarë si busulla udhëzuese për rininë dhe shoqërinë.

Konferenca u përqendrua tek boshti: "Rinia dhe edukimi fetar", ku referuan dhe dhanë mesazhet e tyre, imamët dhe teologët e nderuar: Lavdrim Hamja, Ruzhdi Plangaj, Naim Drijaj, Ervil Kuçi, Arben Halluni dhe Durim Kasemi.

Materialet e kësaj konference do të botohen të plota në një botim të veçantë, sikurse do të publikohen gjatë ditëve në vijim.

ANALIZË E DETAJUAR MBI ZAPTIMIN E VAKËFIT NË ZOGAJ

Paraditën e së martës, më 21 shkurt 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, thirri në një analizë të detajuar mbi vakëfin e lagjes Zogaj, por jo vetëm, menaxherin e pronave dhe juristin e Myftinisë.

Gjatë analizës, u përsërit fakti i nëpërkëmbjes së vazhdueshme që institucionet e vendit po i bëjnë prej më shumë se dy dekadave, vakëfeve të shenjta të muslimanëve. Në këtë kontekst, u rreshtuan shkeljet e ndryshme të institucioneve dhe dëmet e korrupsionit flagrant në këtë vend.

U analizua çështja e vakëfit të zaptuar në Zogaj dhe një ndërtimi flagrant, që ka nisur prej disa vitesh në tokën e uzurpuar të vakëfit dhe që sot vazhdon punimet në qetësi të plotë, edhe me mbështetje politike, për të cilën, Myftinia Shkodër tërheq vëmendjen e subjekteve politike të kenë kujdes të madh, sepse shenjtëria e fesë dhe e vakëfit qëndron mbi çdo interes tjetër të kësaj bote!

Myftinia Shkodër denoncon publikisht katrahurën e uzurpimit të pronave vakëf, legalizimin e paturpshëm të disa ndërtimeve mbi këto toka dhe dhënien e certifikatave në shkelje flagrante me ligjin.

Për këtë, Myftinia Shkodër do të dorëzojë shumë shpejt në prokurori dosjet me kallëzimet konkrete në lidhje me këto shkelje.

Njëkohësisht, do të përdoren të gjitha mjetet legjitime për mostolerimin e askujt që ka abuzuar dhe vazhdon të abuzojë në këtë drejtim; qoftë njeri me pushtet të përkohshëm, qoftë kushdo që ndërron flamujt e partive mbi haramin e uzurpuar!

KONSULTË RRETH SITUATËS SË VAKËFIT TË XHAMISË SË SELVISË

Paraditën e së mërkurës, më 1 mars 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një takim konsultativ mbi gjendjen e vakëfit të vjetër te xhamia e Selvisë.

Myftiu dëgjoi nga juristi i Myftinisë dhe menaxheri i saj mbi gjendjen aktuale të këtij vakëfi, një pjesë e mirë e të cilit është uzurpuar nga ndërtime pa leje. U theksua se nga viti në vit, neglizhenca e institucioneve shtetërore ka krijuar një situatë të vështirë për t'u zgjidhur në favor të pronarit legjitim, si dhe është bërë shkak për konflikte të padëshiruara në mesin e banorëve.

Myftiu kërkoi që në lidhje me vakëfin në fjalë, bri kalasë së Shkodrës, të merren masat që të rrethohet dhe të pastrohen pjesët e mbetura të xhamisë historike, çka përbën edhe daljen në pah të një monumenti të vjetër që i shtohet hartës së pasur të trashëgimisë islame të qytetit të Shkodrës.

U PËRKUJTUA 10 VJETORI I XHAMISË SË RE TË PARRUCËS

Mbrëmjen e së enjtes, më 23 mars 2017, pas namazit të akshamit në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër, zhvilloi një aktivitet përkujtimor, me rastin e 10 vjetorit të përurimit të xhamisë së re të lagjes Parrucë.

Aktiviteti nisi me një fjalë hyrëse nga teologu Lavdrim Hamja, i cili u ndal tek dy momente të spikatura në Kur'an, në raport me rolin e xhamisë në shoqëri.

Më pas referuan: Imam Muhamed B. Sytari, teologu Idmir Plaku, imam i xhamisë "Ebu Bekër" dhe imami i xhamisë Parrucë, teologu Naim Drijaj.

Në referatet e tyre, u hodh dritë mbi historikun e vjetër të xhamisë Parrucë, si një vend adhurimi shekullor për lagjen e vjetër muslimane të Parrucës, roli i xhamisë në edukim dhe ruajtje nga devijimet, si dhe edukata e marrëdhënies me xhaminë dhe e komunikimit në të.

U përmendën me mirënjohje dhe respekt hoxhallarët e nderuar që kontribuuan ndër shekuj, si dhe donatorët e nderuar që mundësuan ngritjen e xhamive në këtë lagje.

Në mënyrë të veçantë, u spikat kontributi i madh i të nderuarit, z. Seit Fishta, që mundësoi ndërtimin e xhamisë së re të Parrucës, si dhe kontributi i vyer i qeverisë turke, që nëpërmjet organizatës TIKA, mundësoi veshjen e xhamisë me qeramikat zbukuruese.

10 vjetori i xhamisë së re të Parrucës, e treta në harkun kohor të tre shekujve të fundit, ka një domethënie shumë të veçantë për muslimanët e Shkodrës, pasi u përurua plot 40 vite pas shkatërrimit të xhamisë së vjetër nga pushteti komunist.

"ISLAMI NUK KËRKON PREJ TEJE TË VRAPOSH DREJT IZOLIMIT!

Ai të nxit që të durosh dhe të përballesh, derisa të triumfojë e mira në veten tënde, në jetën tënde!

LAJMËTARI I ALL-LLAHUT (A.S) i ka lavdëruar ata që përzihen me njerëzit dhe e durojnë të keqen e tyre!"

Shejkh Jusuf El-Karadavi

(President i Unionit Botëror të Dijetarëve të Muslimanëve)

MYFTINIA SHKODËR

www.myftinia-shkoder.org

Botues: **Myftinia Shkodër**
Drejtues: **Imam Muhamed Sytari**

Kryeredaktor: **Lavdrim Hamja**

Tel / Fax: **+355 (0) 224 2081**
Nr. llogarie: **100054 UBA - Shkodër**

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek